



In medias res

Çfarë duhet të ndryshojë në arsim e Kosovës?

Jetojmë në kohën e ndryshimeve marramendës, sepse çdo gjë ndryshon pos ndryshimit. Përballimi i sfidave kohës moderne implikon nevojën e ndryshimeve të përhershme të sistemit të arsimit. Nga aspekti kohor ndryshimet në sistemin e arsimit mund të bëhen si pasojë e ndryshimeve që ndodhin nga zhvillimi teknik dhe teknologjik. Ky lloj ndryshimi në sistemin e arsimit nuk është në funksion të ndryshimeve dhe të avancimeve, por ka rol të përshtatjes, akomodimit, mbijetesës dhe të konservimit të gjendjes. Lloji i tjetër i ndryshimit është ai ndryshëm që bëhet me qëllim që arsimit të shndërrohet në levë të fuqishme të zhvillimit të përgjithshëm. Në këtë rast ndryshimet në sistemin e arsimit u paraprijnë ndryshimeve tjera në shoqëri. Në këtë raste ndryshimet në arsim janë prijëse krahasuar me ndryshimet tjera teknike, teknologjike dhe digjitale. Ndryshimet e deritashme në Kosovë kanë qenë ndryshime të imponuara nga ndryshimet politike, ekonomike dhe shoqërore. Vetë karakteri imponues ka bërë që këto ndryshime të mos arrijnë caqet dhe qëllimet e përcaktuara e as të mos realizohet qëllimi moral i ndryshimeve i cili ka të bëjë me atë se nga ndryshimet e bëra të përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës.

Me qëllim që ndryshimet (me ndryshime në nënkuptojmë të gjitha ndërrimet pozitive të nxitura nga **rinovimet-risitë; nga reformimet si dhe nga transformimet**) të jenë në të shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe që Kosova të shndërrohet në një shtëpi të madhe të të nxënimit dhe të prodhimit të dijeve ato duhet të jenë mirë të programuara dhe të dizajnuara, të bazuara në njohje solide të gjendje së tashme të sistemit të arsimit.

Mosarritja e qëllimeve të parashtruara të ndryshimeve të bëra të deritashme në sistemin e arsimit të Kosovës është shkaktuar nga shkak se ndryshimet në sistemin e arsimit janë bërë me metodën e “Kutisë së Zezë”, përkatësisht për shkak se nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston një **Ekspertizë** shkencërisht bazuar për gjendjen e sistemit të arsimit. Pa një ekspertizë të këtillë nuk mund të përcaktohet as terapia, e as trajektoret me optimale të ndryshimeve në sistemin e arsimit. Deri me tani nuk ekziston një studim referent dhe i plotë i gjendjes në arsimin e Kosovës.

Ekspertiza e bërë do të tregonte ku duhet ndryshuar, çka dhe çfarë duhet ndryshuar, pse duhet ndryshuar, si duhet bërë ndryshimi, cilat do jenë përfitimet e shoqërisë nga këto ndryshime, si duhet bërë monitorimin dhe vlerësimin e arritjes së standardeve të projektuara me ndryshim.

Bërja e ndryshimeve mbi bazën e “mendjes së shëndoshë” do të thotë bërja e serishme e gabimeve që janë bërë në të kaluarën, të cilat objektivisht kanë determinuar dhe po e determinojnë edhe sot gjendjen e tashme.

Ajo që dihet është se ndryshimet në sistemin e arsimit të Kosovës duhet të jenë shumë të thella, gjithëpërfshirëse, strukturore dhe që janë në pajtim me zhvillimet dhe standardet e Bashkësisë Evropiane.

Mbi bazën e ekspertizës duhet të përcaktohet një vizion që do të përmbledh një ëndërr apo një imazh të dëshiruar që i përmbush interesat e qytetarëve të Kosovës pavarësisht nga çfarëdo përkatësie a origjine (etnike, racore, gjuhësore, fetare, moshore, shoqërore-ekonomike etj).

Shkroi: Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Më 13-14 mars 2009 është mbajtur seminari i pestë me titull “Të nxënit në bashkëpunim” për 7 grupe të mësimit në klasa që janë duke u trajnuar në kuadër të Programit të MKLSH. Seminari është mbajtur për mësimit në Prishtinë (dy grupe), Pejë, Ferizaj, Gjiçan, Gjakovë dhe Mitrovicë. Nga raportet e trajnerëve vërehet se mësimit kanë përvetësuar shumë mirë filozofinë e programit, teknikat e paraqitura deri tash dhe me sukses janë duke i zbatuar në klasat e tyre.

■ Gjatë muajit mars është bërë monitorimi i 36 mësimit të komunës së Gjakovës, të cilët janë duke u trajnuar në bashkëpunim me Qendrën Didaktike në Gjakovë. Trajnerët e këtij grupi janë shprehur jashtëzakonisht të kënaqur me performancën e mësimit gjatë zbatimit me sukses të teknikave dhe strategjive të programit të MKLSH. Diskutimi i orëve të monitoruara është planifikuar të mbahet më 4 prill 2009.

■ Po ashtu, gjatë muajit mars është mbajtur seminari i pestë dhe i gjashtë për 36 mësimit të komunës së Podujevës, të cilët janë duke e vijuar trajnimin e MKLSH me vet financim. Monitorimi i këtyre mësimit do të realizohet gjatë muajit prill.

■ KEC në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe DKA e Prizrenit ka filluar trajnimin e 220 mësimit, të organizuar në 7 grupe për metodologji të reja të mësimit dhe të nxënit. Grupet janë organizuar: në Prizren (4 grupe), në Suharekë (1 grup) dhe në

Mitrovicë (2 grupe). Këto grupe kanë filluar trajnimin më 14-15 mars 2009 dhe në mënyrë intensive deri në fund të mars janë përfunduar 3 seminare. Gjatë marsit ka filluar dhe monitorimi i këtyre mësimit në klasa. Përfaqësues të DKA-ve në Prizren dhe Mitrovicë, si dhe koordinatori e programit ka vizituar dhe përshëndetur mbajtjen e këtyre seminareve.

Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla

■ Gjatë muajit mars janë mbajtur tri tryeza të rumbullakëta dhe një punëtori njëditor, në të cilin është prezantuar Modeli i Rrjetit Mbrojtës për parandalimin e dhunës në shoqëri dhe shkolla.



Në këtë punëtori janë prezantuar edhe rezultatet e Hulumtimit të shpejtë mbi gjendjen e Komiteteve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës nëpër shkolla, dhunën nëpër shkolla dhe sigurinë e përgjithshme nëpër shkolla.

(Shih raportin në webfaqe: www.chlidrights-ks.org).

■ Gjatë këtij muaji është hartuar dhe Raporti Narrativ tremujor i cili është botuar po ashtu në webfaqen e sipërpërmendur. Gjithashtu, gjatë muajit është hartuar një model për pilotimin e Rrjetit mbrojtës.

Hap pas Hapi

■ Gjatë muajit mars, respektivisht gjatë kohës së pushimeve pranverore në tërë vendin janë organizuar trajnime të programit “Hap pas hapi” për mësimdhënësit e shkollave fillore. Të gjitha trajnimet u realizuan sipas dinamikës së paraparë.



Trajnimet që janë zhvilluar kanë qenë për klasën e parë, dytë dhe katërt.

Orari zhvillimit të trajnimeve ishte ky:

- **Prishtinë:** klasa e dytë (grupi I), me datat 14, 15, 16 mars.
- **Gjilan:** klasa e dytë, me datat 14, 15, 16 mars.
- **Istog:** klasa e parë, trajnimi fillestar, me datat 14, 15, 21, 22, 24 mars.
- **Prishtinë:** klasa e dytë (grupi II), me datat 23, 24, 25 mars.
- **Prishtinë:** klasa e dytë (grupi III), me datat 23, 24, 25 mars.
- **Gjakovë:** klasa e katërt (grupi I) me datat 22, 23, 24 mars.
- **Gjakovë:** klasa e katërt (grupi II) me datat 24, 25, 26 mars.

KOSOVISION Contest

■ Implementimi i projekteve të shkollave fituese ka filluar në muajin shkurt. Pjesa e parë e mjeteve për implementim iu është dhënë shkollave. Të gjitha projektet kanë filluar me kohë dhe po zhvillohen në bazë të planit të cilin e kanë organizuar vet mësuesit. Gjatë muajit mars, disa nga projektet fituese kanë pasur edhe vizita nga përfaqësues

zvicëran dhe Zyra e Ambasadës së Zvicrës, në Prishtinë. Vizitorët ishin shumë të kënaqur me punën e projekteve. Këto vizita do të organizohen edhe gjatë muajve tjerë në vijim.



Disa nga projektet nuk kanë filluar punën për shkak të motit të lig, duke pasur parasysh se projektet e tyre do të zhvillohen jashtë objekteve shkollore. Gjatë këtij muaji është mbajtur edhe një punëtori gjysmë ditore me stafin lokal të projektit. Qëllimi i punëtorisë ka qenë që të marrim sa më shumë informacione rreth zhvillimit të projekteve.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të këtij projekti të financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, aktivitetet janë duke u zhvilluar sipas dinamikës së projektit. Pasi që shkollat të cilat janë pjesëmarrëse në projekt janë zgjedhur, këtë muaj ka vazhduar takimi dhe njoftimi i shkollave dhe Drejtorive Komunale me projektin. Në Komunën e Fushë Kosovës dhe të Prishtinës janë mbajtur takimet me drejtorët e Drejtorive Komunale. Po ashtu edhe me drejtorët e shkollave përfituese të projektit, është mbajtur një takim në lokalet e KEC me qëllim të njoftimit të tyre me punën në vazhdim. Është bërë përzgjedhja e monitorëve nga të dy regjionet.

■ Në muajin prill planifikohet të mbahet punëtorja e parë dy ditore ku do të punohet në një kornizë monitorimi për metodologjinë e punës në projekt.

Përgatitjet për këtë punëtori kanë filluar në fund të këtij muaji.

Duke ditur se në këtë projekt do të ketë edhe trajnime për nxënës, ne kemi filluar edhe me mbledhjen e materialeve me qëllim që të zhvillohet një program trajnimi shumë i përshtatshëm dhe i kuptueshëm për nxënës. Manuali do të duhet të jetë i botuar deri në fund të muajit qershor të vitit 2009.

Prevention on Peer Violence

■ Ashtu siç ishte e planifikuar, gjatë këtij muaji është mbajtur trajnimi i parë me 10 shkollat e përzgjedhura të projektit. Në trajnim morën pjesë 10 drejtorë të shkollave të përcjellur me nga dy mesimdhënës, 5 psikologë të cilët do të vëzhgojnë punën e shkollave gjatë këtij projekti dhe trajnerët të cilët mbajtën trajnimin dhe të cilët ishin nga Sllovenia. Trajnimi ishte tre ditor dhe u mbajt në Prevallë. Tani jemi duke bërë përgatitjet e para për vazhdimin e trajnimeve në shkollat pjesëmarrëse të projektit.



Pjesa e dytë e trajnimit për trajner do të mbahet gjatë muajit shtator.



Gjatë muajit prill do të organizohen edhe tri punëtoritë në dhjetë shkollat e zgjedhura të cilat janë pjesë e projektit. Tani janë duke u bërë edhe përgatitjet e këtyre punëtorive.

Cilësia e arsimit në regionin e Dukagjinit (AVSI-CESAL)

■ Projekti është duke shkuar mirë. Gjatë këtij muaji është bërë kompletimi i pyetësorëve të mbledhur dhe është punuar intenzivisht në futjen e të dhënave në databazë.

Përgatiti: Petrit Tahiri